

**AKTI I THEMELIMIT  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
“ KOPLIKU TRAVEL “**

Ne baze te ligjit 7512 date 10.08.1991 “ Per sanksionimin e prones private,te nismes se lire dhe privatizimit “ ,ligjit 7638 date 19.11.1992 “ Per shoqerite tregtare “ dhe te ligjit 7667 date 28.1.1993 “ Per rregjistrimin e shoqerive ne rregjistrin tregtare ,“me vullnetim tim te lire te shprehur ne nenshkrimin e ketij akti,une,Arben Mustali,banues ne qytetin Shkoder kam krijuar shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar “ KOPLIKU TRAVEL “ Sh.P.K.,Shkoder.

**OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

Objekti i veprimtarise se kesaj shoqerije eshte : Agjensi turistike brenda dhe jashte vendit.

**SELIA E SHOQERISE**

Selia e shoqerise “ KOPLIKU TRAVEL “ SH.P.K.,Shkoder eshte ne qytetin Shkoder,prane Qendres Tregtare “ Gjylbegu “ Shkoder.

**KOHEZGJATJA**

Jetegjatesia e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar “ KOPLIKU TRAVEL “ Sh.P.K.,Shkoder eshte mbi 10 vjet.Afatet mbi zgjatjen apo mbylljen e aktivitetit behen sipas kerkesave te ketij statuti.

**KAPITALI THEMELOR**

Kapitali themelor i shoqerise “ KOPLIKU TRAVEL “ Sh.P.K.,eshte 100 000 leke,qe vjen nga kontributi i ortakut te vetem.

Kjo shoqeri do te kete dhe do te mbaje llogarine e saj duke u mbeshtetur tek leku shqiptare dhe valute e huaj.

## DREJTIMI I SHOQERISE

Ortak i vetem i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "KOPLIKU TRAVEL" Sh.P.K.,Shkoder eshte Arben Mustali,i cili do te jete njekohsisht dhe administratori i kesaj shoqerise.

Ortaku i vetem i kesaj shoqerie do te procedoje me vendim-marrjet qe kane te bejne me mbarvajtjen e shoqerise vetem nepermjet vendimeve te marra nga ai.

Marredheniet e punes ne shoqeri do te rregullohen nepermjet kontrates se punes.Per ceshitet qe nuk rregullohen me kontraten e punes,do te rregullohen ne baze te legjislacionit ne fuqi.

Ky akt themelimi pasi u lexua dhe u gjet konform vullnetit te ortakut te vetem,u firmos prej.

**ORTAKU I SHOQERISE  
"KOPLIKU TRAVEL"  
ARBEN MUSTALI**




REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE SHKODER

Nr.Kol. 517 Nr.Rep. \_\_\_\_\_.

## AUTENTIFIKIM NENSHKRIMI

Sot me daten 6/12 2005,ne Shkoder,para meje noteres Genciana Llambi Shkreli u paraqit personalisht i quajhuri Arben Mustali,i Qamilit,dtl.1970,per identitetin e te cilit u sigurova ne baze te leter njoftimit te tij personal dhe si konstatova se i ka te gjitha aftesite e kerkuara nga ligji I vertetova nenshkrimin e siperm mbi aktin e themelit te shoqerise tregtare "KOPLIKU TRAVEL" Sh.P.K.,Shkoder.

**NOTERE  
GENCIANA LL.SHKRELI**



**S T A T U T**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“ KOPLIKU – TRAVEL ”**

**NENI 1**  
**EMERTIMI**

Ne baze te ligjit 7512 date 10.8.1991 “ Per sanksionimin dhe mrojtjen e prones private e privatizimit,te niesmes se lire etj. “,te ligjit 7638 date 19.11.1992 “ Per shoqerite tregtare “ dhe te ligjit 7667 date 28.1.1993 « Per rregjistrimin e shoqerive ne rregjistrin tregtare «,une i quajturi Arben Qamil Mustali,dtl.1970,banues ne Shkoder,lagja Vojo Kushi,rruga 7 Shkurti, Pall.1110,Shkoder,me vullnetim tim te lire,te shprehur ne nenskrimin e aktit te themelimit qe i bashkangjituete ketij statuti,kam krijuar shoqerine me pergjegjesi te kufizuar “ KOPLIKU TRAVEL “.

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar “ Kopliku Travel “ Sh.P.K., Shkoder e fiton personalitetin juridik nga dita e rregjistrimit ne Gjykatën e rrethit gjyqesore Titane.Ajo e zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me normat e legjislacionit shqiptare ne fuqi,duke e shtrire aktivitetin e saj ne te gjithë territorin e shqiperise dhe jashte saj.

**NENI 2**

Objekti i veprimtarise se shoqerise me pergjegjesi te kufizuar “ Kopliku Travel “ Sh.P.K.Shkoder eshte : Agjensi turistike .,brenda dhe jashte vendit.

**NENI 3**

Selia e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar “ Kopliku Travel “Sh.P.K.,eshte ne qytetin Shkoder,prane Qendres Tregtare “ Gjylbegu “.

Kjo shoqeri mund te hapi filialet e saja ne rrethe te ndryshme te vendit dhe jashte saj,duke zbatuar te gjithë legjislacionin perkates ne vendet ku hapet.

## **NENI 4**

### **KOHEZGJATJA**

Jetegjatesia e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " Kopliku Travel " Sh.P.K.,eshte mbi 10 vjet.Ajo mund te shperndahet para ketij afati Vetem me vendimin e ortakut te vetem te kesaj shoqerise ne te gjitha rastet e percaktuara ne nenin mbi shperndarjen e shoqerise ne kete statut..

## **NENI 5**

### **KAPITALI THEMELOR**

Kapitali themelor i shoqerise " Kopliku Travel " Sh.P.K.,Shko-der,eshte 100 000 leke,qe vjen nga kontributi I vetem I ortakut te shoqerise.

Ndryshimi i mases se kapitalit,si per shtimin dhe pakesimin,behet me vendimin e ortakut te vetem te kesaj shoqerise.

## **NENI 6**

### **DREJTIMI I SHOQERISE**

Ortak i vetem i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " Kopliku Travel " Sh.P.K.,Shkoder eshte Arben Mustali,I cili do te jete njekohsisht edhe administratori i kesaj shoqerise.

Ortaku I vetem I kesaj shoqerise do te procedoje ne vendim-marrjet qe kane te bejne me mbarvajtjen e shoqerise vetem nepermjet vendimeve te marra nga ai.

Keshtu,ai ka te drejte te marre pjese ne ankande,perpilimin e kontratave dhe te cdo akti tjeter juridik te cfare do lloji qofshin qe kane te bejne me veprimtarine e shoqerise,ne perfaqesimin e shoqerise ne te gjitha strukturat shoqerore dhe gjyqesore,ose caktimin e nje perfaqesuesi jo-ortake me prokure ne kryerjen e ketyre veprimeve,te hapi llogari rrjedhese ne bankat e shqiperise apo jashte saj,te marri pjese ne sipermarrje financiare te te gjitha llojeve,te bleje,te kembeje e te tjetersoje pasuri te ndryshme qe I sherbejne shoqerise,te marri ne pune edhe persona te tjere si specialiste etj.,gjithmone me kontrate,si dhe cdo veprim tjeter qe do te jete me qellim te mire te shoqerise.

## **NENI 7**

Ne rast nevoje ose kur e kerkon ligji,kontrolli I shoqerise mund

te kryehet nga eksperti kompetent. Caktimi I ekspertit mund te behet nga ortaku ne formen e caktuar me siper. Kur konstatohet se eksperti I caktuar nuk kryen ekspertimin apo eshte e pamundur te kryhet ekspertimi apo verehen gabime, ky I fundit shkarkohet ne te njejten menyre qe eshte marre ne kete cilesi.

#### **NENI 8**

Te gjitha te punesuarit ne kete shoqeri jane te detyruar te ruajne sekretin e punes te kesaj shoqerie. Kete kane edhe pas largimit nga puna. Se kush perben sekret i punes ne kete shoqeri, percaktohet ne rregulloren e brendshme ku u vihen ne dijeni te punesuarve ne kontraten e punes qe lidhet me punedhenesin.

#### **NENI 9 SHPERNDARJA E SHOQERISE**

Shperberja e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " Koplík Travel " Sh.P.K., Shkoder, mund te vije ne cdo kohe dhe per cfaredo shkak, si per humbjen e kapitalit te shoqerise, vazhdimi I veprimtarise eshte I pamundur, apo kur e parashikon ligji. Shperberja behet me vendim te ortakut te vetem te saj, dhe me kete rast caktohet nje apo me shume likujdatore te cileve u caktohet menyra e likujdimit. Likujdatorët ne radhe te pare likujdojne detyrimet ndaj shtetit, te tretet dhe pastaj shperndajne fitimin.

#### **NENI 10**

Persa nuk shprehemi ne kete statut do tu referohemi shtesave e ndryshimeve te mevonshme si dhe akteve te tjera qe do te nxjerren. Kjo shoqeri ne zbatim te ligjit per ushtrimin e veprimtarise se saj si dhe nevojave qe do te diktohen.

Ndryshimet ne statut do te behen ne te njejten menyre si per nnxjerren e tij.

#### **NENI 11**

Ky statut pasi u lexua nga ortaku i vetem I kesaj shoqerie dhe del se eshte shprehur vullneti I tij, u firmos pa verejtje.

**ORTAKU I VETEM I SHOQERISE**  
**“ KOPLIK TRAVEL “ SH.P.K.**  
**ARBEN MUSTALI**

